



# NJOFTIM PËR KONTRATË

## *Kontratë Furnizimi Procedurë e hapur*

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

Data e shpalljes: 01.8.2025

Nr. i Prokurimit: "BQK 25 054 121"

### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: +383 38 222 055/451	

### II LËNDA E KONTRATËS

#### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizim me softuer për nevoja të auditimit të brendshëm"
Lloji i prokurimit: Kontratë furnizimi
Vendi kryesor i realizimit: Prishtinë
Informacione të marrëveshje afatgjatë: n/a
Variantet pranohen: Jo
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00 Euro
Ndarja në Pjesë: Jo

### III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhen kontraktuesit të cilët do të realizojnë në mënyrë profesionale furnizimin me softuer për nevoja të auditimit të brendshëm sipas specifikave teknike dhe funksionale të parapara në Dosjen e Tenderit.

### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim. **Vëmendje për operatorët ekonomik që t'i kenë parasysh kërkesat sipas tabelës në vijim rreth vendosjes së evidencave/dëshmime në ofertat e tyre.**

<i>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 kur aplikohet) janë të obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	<b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. <b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës i cili gjendet në dosjen e tenderit.
	<b><u>Kërkesa 2:</u></b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C. <b><u>Evidenca 2:</u></b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në Kërkesat 1, 2 dhe 3 të kësaj tablele.
	<b><u>Kërkesa 3:</u></b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium) <b><u>Evidenca 3:</u></b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohet si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së

<sup>1</sup> Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë e profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 4:</u></b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 5:</u></b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b><u>Evidenca 5:</u></b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b><u>Kërkesa 6:</u></b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b><u>Evidenca 6:</u></b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6 të kësaj tablele.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të</p>	<p><b><u>Kërkesa 7:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës se ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë).</p> <p><b><u>Evidenca 7:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat relevante të furnizimit në zhvillim apo implementim në softuer ose referencat që</p>

<p><i>dokumenteve (kërkesat 7, 8 dhe 9) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p>evidentojnë realizimin e furnizimit të tillë dhe b) kopjet e kontratave përkatëse</p> <p><b>Kërkesa 8:</b> Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><b>Evidenca 8:</b> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate) duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve.</p> <p><b>Kërkesa 9:</b> Ofertuesit duhet të prezantojë me ofertë ekipin profesional që do të angazhojë.</p> <p><b>Evidenca 9:</b> CV-të me profilin e stafit që do të angazhohen në projekt</p>
--	---

## V

V.1 Lloji i procedurës: “Procedurë e hapur”, sipas *Nenit 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (dhjetor 2024)*.

## VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS:

“Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët”, në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK.

## VII INFORMATA ADMINISTRATIVE PËR OFERTUESIT

<p>Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 13.08.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>.</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 13.08.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>.</p>
<p>Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të ofertave, data: 15.08.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.</p>
<p>Takimi për hapjen e ofertave, data: 15.08.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.</p>
<p>Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 1,000.00 € (një mijë euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh nga data e hapjes së ofertave</p>
<p>Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.</p>
<p>Periodha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertës.</p>

Dokumentet me pagesë: Jo
--------------------------

### VIII. ANKESAT

<p>Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.</p>
--

### IX. ADRESA

Rr. “Garibaldi” 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763